

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

1 qershor 2009
Prishtinë
Ap.-Kz No. 106/2007
Pn-Kr 165/2009

NË EMËR TË POPULLIT


Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Emilio GATTI Gjyqtar i EULEX-it si Kryetar i Kolegjit, Norbert KOSTER Gjyqtar i EULEX-it dhe Gjyqtarët Vendor Kosovar Agim KRASNIQI, Avdi DINAJ dhe Miftar JASIQI si anëtar të kolegjit,

në procedurën penale kundër:

Vladimir UKAJ-t, i biri i Skender dhe Nuriye BRAHËS, i lindur më 1 dhjetor 1974 në Puke, Shqipëri, shtetas i Shqipërisë, shitës i perimeve dhe shalqinjve, me vendbanim në lagjen Kamëz në Tiranë, Shqipëri, i pamartuar, din shkrim lexim, shkollën e mesme të kryer, me gjendje të mesme ekonomike, i padënuar më parë, i mbajtur në paraburgim vazhdimisht që nga data 27 korrik 2004 prej orës 10:00; i akuzuar për kryerje të veprës penale të Dhunimit (pika I, e përcaktuar me nenin 78.1 të LPK-së të ndryshuar me nenin 1.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/1), të dy veprave penale të Mundësimit të Prostitucionit (pika II dhe III e përcaktuar me nenin 201.3 të KPPK-së), të dy veprave penale të Trafikimit me Njerëz (pika VII e përcaktuar me nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/4 lidhur me nenin 22 të KP të RSFJ-së dhe Pikën XII të përcaktuar me nenin 139.2 lidhur me nenin 23 të KPPK-së).

Sabri ISLAMI-t, i biri i Ali dhe Sibe SELIMAJT, i lindur më 19 korrik 1972 në Fshatin Flete, Puke, Shqipëri, shtetas i Shqipërisë, vozitës, me vendbanim në Rugën Vëllezërit Frashri Nr. 18 në Prizren, Kosovë; i martuar me një fëmijë; din shkrim lexim; shkollën fillore të kryer; me gjendje të mesme ekonomike; i padënuar më parë; i mbajtur në paraburgim vazhdimisht që nga data 1 korrik 2004 prej orës 22:00; i akuzuar për kryerje të dy veprave penale të Trafikimit me Njerëz (pika VII e përcaktuar me nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/4 lidhur me nenin 22 të KP të RSFJ-së dhe Pikën XII të përcaktuar me nenin 139.2 lidhur me nenin 23 të KPPK-së).

Duke vendosur mbi 1) ankesat e parashtruara nga avokatja mbrojtëse Myrvete Collaku në emër të Vladimir UKAJ-t më 24 shtator 2007 dhe nga avokati mbrojtës Nexhad Elshani në emër të Sabri ISLAMI-t më 1 tetor 2007 dhe mbi 2) kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës Besim Kocinaj në emër të Sabri ISLAMI-t më 18 shtator 2007 kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin penal Nr. Ap-Kz 478/2005, të datës 28 maj 2007, refuzon ankesat e të dy të pandehurve dhe të Robert SYLAJ-t kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren në rastin penal P.



Nr. 02/2005 të datës 20 korrik 2005 që dënon Vladimir UKAJ-n për kryerjen e veprave të lartpërmendura penale të Dhunimit, Mundësimit i Prostitucionit dhe të Trafikimit me Njerëz, Sabri ISLAMI-n për kryerjen e veprave të lartpërmendura penale të Trafikimit me Njerëz dhe Robert SYLAJ-n për kryerjen e veprave të Falsifikimit të Dokumenteve, Dhunimit dhe Trafikimit me Njerëz.

Pas leximit të mendimit dhe propozimit të Prokurorit të ZPSK-së Znj. Deborah Wilkinson dhe Znj. Bademane Sllamniku dhe pas shqyrtimit e votimit të mbajtur më 1 qershor,

Duke vepruar sipas neneve 410, 422 dhe 456 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) lëshon këtë:

VENDIM


Ankesa e parashtruar nga avokatja mbrojtëse Myrvete Collaku në dobi të Vladimir UKAJ-t më 24 shtator 2007 HEDHET si e palejueshme.

Ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës Nexhad Elshani në dobi të Sabri ISLAMI-t më 1 tetor 2007 HEDHET si e palejueshme.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Besim Kocinaj në dobi të Sabri ISLAMI-t më 18 shtator 2007 REFUZOHET si e pabazuar.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 28 maj 2007, Ap – Kz 478/2005 KONFIRMOHET NË TËRËSI

Shpenzimet e këtyre procedurave ankimore do ti bartin njësoj të dy të pandehurit Vladimir UKAJ dhe Sabri ISLAMI.



ARSYETIMI

A. Rrjedha e Procedurës

1. I pandehuri **Vladimir UKAJ** ishte akuzuar me aktakuzën e Ndryshuar CC Nr. 156/04¹ e paraqitur më 15 qershor 2005, me gjetjet dhe dënimin nga Gjykata e shkallës së parë Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P. No. 02/2005 si në vazhdim:

- **Dhunim (Pika I)** i 17 vjeçares Xhulia DEDA dikur në dhjetor 2003; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë në nenin 78.1 të LPK-së i ndryshuar nga neni 1.4 i Rregullores të UNMIK-ut No. 2003/1, atij i është shqiptuar dënimi me tre vjet burgim;

- **Mundësim i Prostitucionit (Pika II)** përfshirë Xhulia DEDA në janar 2004; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë në nenin 201.3 të KPPK-së dhe është dënuar me tre vjet burgim;

- **Mundësim i Prostitucionit (Pika III)** përfshirë Xhulia DEDA në mes të dhjetorit 2003 dhe janarit 2004; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë në nenin 201.3 të KPPK-së dhe është dënuar me tre vjet burgim;

- **Trafikimi me Njerëz (Pika VII)** përfshirë Xhulia DEDA në mes të dhjetorit 2003 dhe janarit 2004; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë në nenin 2.2 të Rregullores të UNMIK-ut përfshirë Xhulia DEDA në mes të dhjetorit 2003 dhe janarit 2004; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë me nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/4 lidhur me nenin 22 CC RSFJ-së dhe është dënuar me shtatë vite burgim;


- **Dhunim (Pika XI)** përfshirë 15-vjeçaren Xhoana LALA më 1 korrik 2004, nga e cila i pandehuri është liruar;

- **Trafikim me Njerëz (Pika XII)** përfshirë Xhoana LALA më 30 qershor 2004; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë me nenin 139.2 të KPPK-së lidhur me nenin 23 të KPPK-së dhe është dënuar me shtatë vite burgim;

Me një dënim total sipas nenit 71.1 të KPPK-së prej dymbëdhjetë viteve burgim².

¹ Aktakuza origjinale e datës 23 nëntor 2004 nuk ka përmbajtur Pikat I dhe III përfshirë akuzat penale mundësimi i prostitucionit. Pikat II dhe III të cekura më lart janë përfshirë në Aktakuzën e Ndryshuar si rezultat i dëshmive të gjykimin. Aktakuza origjinale e datës 26 nëntor gjithashtu është ndryshuar gjatë gjykimin me fshirjen e akuzave penale kundër Vladimir UKAJ për mundësimin e prostitucionit duke përfshirë Olga Stici dhe trafikim me njerëz duke përfshirë Aliona BRESCANU sepse dëshmitari i vetëm i atyre akteve kriminale, Christian POPESCU, nuk ka qenë në gjykim.

² Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P. No. 02/2005 ka refuzuar, sipas nenit 389, paragrafi 1 i KPPK-së, akuzën nën nenin 139 paragrafi 1 të KPPK-së kundër Vladimir UKAJ për trafikim me njerëz (Aliona BRESCANU) cila pretendohet të ketë ndodhur në vitin 2003, akuzën në fjalë ashtu siç është përcaktuar në Aktakuzën origjinale të paraqitur më 26 nëntor 2004. Gjithashtu është refuzuar akuzën nën nenin 201, paragrafi 3 i KPPK-së kundër Vladimir UKAJ për mundësim të prostitucionit (Olga STICI) e cila pretendon të ketë ndodhur më në fillim të vitit 2003, akuzën në fjalë ashtu siç është përcaktuar në Aktakuzën origjinale të paraqitur më 26 nëntor 2004.



2. I pandehuri Sabri ISLAMI është akuzuar me Aktakuzën e Ndryshuar CC No. 156/04 të paraqitur më 15 qershor 2005, me gjetjet dhe dënim nga Gjykata e shkallës së parë, Aktgjykimi P. No. 02/2005 i Gjykatës së Qarkut në Prizren si në vazhdim:

- **Trafikimi me Njerëz (Pika VII)** përfshirë Xhulia DEDA në mes të dhjetorit 2003 dhe janarit 2004; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë me nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/4 lidhur me nenin 22 CC RSFJ-së dhe është dënuar me shtatë vite burgim;

- **Dhunim (pika XI)** përfshirë 15-vjeçaren Xhoana LALA më 1 korrik 2004, nga e cila i pandehuri është liruar;

- **Trafikim me Njerëz (Pika XII)** përfshirë Xhoana LALA më 30 qershor 2004; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë me nenin 139.2 të KPPK-së lidhur me nenin 23 të KPPK-së dhe është dënuar me shtatë vite burgim;

me një dënim total sipas nenit 71.1 të KPPK-së prej dhjetë viteve burgim.

3. I pandehuri Robert SYLAJ është akuzuar me Aktakuzën e Ndryshuar CC No. 156/04³ të paraqitur më 15 qershor 2005, me gjetjet dhe dënim nga Gjykata e shkallës së parë, Aktgjykimi P. No. 02/2005 i Gjykatës së Qarkut në Prizren si në vazhdim:

- **Falsifikim i Dokumenteve (Pika IV)** përfshirë Xhulia DEDA; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë me nenin 332.1 të KPPK-së dhe është dënuar me një vit burgim;

- **Dhunim (Pika V)**) i 17 vjeçares Xhulia DEDA dikur në dhjetor 2003; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë në nenin 74.1 të LPK-së i ndryshuar nga neni 1.1 i Rregullores të UNMIK-ut No. 2003/1, atij i është shqiptuar dënimi me pesë vjet burgim;

- **Trafikim me Njerëz (Pika VI)** përfshirë Xhulia DEDA në dhjetor 2003; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë me nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/4 lidhur me nenin 22 CC RSFJ-së dhe është dënuar me shtatë vite burgim;


- **Trafikim me Njerëz (Pika VIII)** përfshirë Xhoana LALA në qershor 2004; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë me nenin 139.2 të KPPK-së dhe është dënuar me shtatë vite burgim;

- **Falsifikim i Dokumenteve (Pika IX)** përfshirë Xhoana LALA; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë me nenin 332.1 të KPPK-së dhe është dënuar me një vit burgim;

- **Dhunim (Pika X)** përfshirë 15-vjeçaren Xhoana LALA më 30 qershor 2004; i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të paraparë me nenin 193 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pikat 1 dhe 3 të KPPK-së dhe është dënuar me pesë vite burgim;

- **Dhunim (pika XI)** përfshirë 15-vjeçaren Xhoana LALA më 1 korrik 2004, nga e cila i pandehuri është liruar;

³ Aktakuza origjinale e paraqitur më 24 nëntor 2004 nuk ka përmbajtur Pikat IV, V, VI, VIII dhe X përfshirë falsifikimin e dokumenteve përfshirë Xhulia DEDA, dhunim i të dyjave Xhulia DEDA dhe Xhoana LALA dhe trafikimin me njerëz përfshirë të dyjat Xhulia DEDA dhe Xhoana LALA. Pikat IV, V, VI, VIII dhe X janë përfshirë në Aktakuzën e Ndryshuar si rezultat i dëshmisë së gjykimt.



me një dënim total sipas nenit 71.1 të KPPK-së prej dymbëdhjetë viteve burgim.

4. Shqyrtimi gjyqësor para Gjykatës së Qarkut në Prizren është bërë bashkërisht kundër të tre të pandehurve. Tre të pandehurit kanë parashtruar ankesat e tyre me kohë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila ka mbajtur seancën e saj më 28 mars 2007 dhe, pas shqyrtimeve po atë ditë dhe më 24 dhe 28 maj 2007 lëshoi një aktgjykim me të cilin refuzohen në tërësi ankesat e propozuara në dobi të tre të pandehurve dhe si pasojë e asaj konfirmohet në tërësi Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut në Prizren.

5. Aktgjykimi me shkrim i Gjykatës Supreme 28 maj 2007 ju është dërguar të pandehurve dhe avokatëve mbrojtës mes datës 27 gusht dhe 10 shtator 2007.

Një ankesë në dobi të Vladimir UKAJ-t ishte parashtruar nga avokatja e tij mbrojtëse Myrvete Collaku më 24 shtator 2007.

Një ankesë në dobi të Sabri ISLAMI-t ishte parashtruar nga avokati i tij mbrojtës Nexhat Elshani më 1 tetor 2007.

Një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në dobi të Sabri ISLAMI-t ishte parashtruar nga avokati i tij mbrojtës Besim Kocinaj më 18 shtator 2007.

6. ZPPK-ja paraqiti mendimin e vet më 16 janar 2009 dhe më 7 maj 2009.

7. Gjykata Supreme mbajti seancën e saj mbi mjetet juridike të lartpërmendura më 1 qershor 2009.

B. Përfundimet e gjykatës

Siç shihet më lart, këto mjete juridike janë paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme më 28 maj 2007.

I

1. Ankesa në dobi të Vladimir UKAJ-t ishte parashtruar nga avokatja e tij mbrojtëse Myrvete Collaku më 24 shtator 2007, sipas nenit 430 të KPPPK-së.

Ankesa është parashtruar jashtë rasteve të përcaktuara me ligj sepse:

1. ndaj të pandehurit nuk është shqiptuar një dënim afatgjatë me burg (neni. 430.1 nr. 1) por një dënim total prej 12 vitesh burgim;
2. gjykata e shkallës së dytë nuk kishte mbajtur seancë dëgjimore dhe nuk kishte bërë ndryshim të gjendjes faktike prej asaj të gjykatës së shkallës së parë (neni 430.1 nr. 2);
3. gjykata e shkallës së dytë nuk kishte ndryshuar aktgjykimin lirues (neni 430.1 nr. 3) por konfirmoi aktgjykimin dënues të shkallës së parë.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 28 maj 2007 është vendim përfundimtar, kundër të cilit mund të propozohet vetëm një mjet i jashtëzakonshëm



juridik. Mjeti juridik i propozuar në emër të, të pandehurit jo vetëm që ka emrin ankesë por edhe i drejtohet dispozitës ligjore (neni 430 i KPPK-së) lidhur me ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë. Prandaj, nuk ka dyshim se çfarë mjeti juridik është propozuar dhe se ky mjet juridik nuk është i lejuar me ligj. Për këto arsye kjo Gjykatë e konsideron **ankesën** e parashtruar të palejuar me ligj, dhe prandaj sipas nenit 422 të KPPK-së duhet të hedhet poshtë.

II

2. Ankesa në dobi të Sabri ISLAMI-t e parashtruar nga avokati mbrojtës Nexhat ELSHANI më 1 tetor 2007.

Ankesa është paraqitur jashtë rasteve të përcaktuara me ligj sepse:

1. ndaj të pandehurit nuk është shqiptuar një dënim afatgjatë me burg (neni 430.1 nr. 1) por një dënim total prej dymbëdhjetë vitesh burgim;
2. gjykata e shkallës së dytë nuk kishte mbajtur seancë dëgjimore dhe nuk kishte bërë ndryshim të gjendjes faktike prej asaj të gjykatës së shkallës së parë (neni 430.1 nr. 2);
3. gjykata e shkallës së dytë nuk kishte ndryshuar aktgjykimin lirues (neni 430.1 nr. 3) por konfirmoi aktgjykimin dënues të shkallës së parë.


Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 28 maj 2007 është vendim përfundimtar, kundër të cilit mund të propozohet vetëm një mjet i jashtëzakonshëm juridik. Mjeti juridik i propozuar në emër të, të pandehurit jo vetëm që ka emrin ankesë por edhe i drejtohet dispozitës ligjore (neni 430 i KPPK-së) lidhur me ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë. Prandaj, nuk ka dyshim se çfarë mjeti juridik është propozuar dhe se ky mjet juridik nuk është i lejuar me ligj. Për këto arsye kjo Gjykatë e konsideron **ankesën** e parashtruar të palejuar me ligj, dhe prandaj sipas nenit 422 të KPPK-së duhet të hedhet poshtë.

III

3. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në dobi të Sabri ISLAMI-t e paraqitur nga avokati mbrojtës Besim KOCINAJ më 18 shtator 2007.

Avokati mbrojtës pohon:

- a) shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale:
 - aktvendimi i shkallës së parë është i bazuar në dëshmi të palejueshme, do të thotë në deklarata të dëshmitarëve të dhëna në Polici, të cilat është dashur të ndahen prej dokumenteve të dosjeve të rastit pasi që ato janë vetëm informacione që i ka përdorur policia për të ngritur kallëzimin penal;
 - dispozitivi i aktvendimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me pjesën e arsyetimit;



- pjesa e arsytimit të aktvendimit të shkallës së parë kufizohet vetëm në përshkrimin e deklaratave të, të dyshimtëve dhe dëshmitarëve pa përmbajtje të asnjë baze apo fakti esencjal për vërtetimin e dëshmive të administruara;
- arsytimit të aktvendimit të shkallës së parë i mungon përcaktimi i dëshmive që ishin përdorur për vërtetimin e gjendjes së fakteve dhe besueshmërinë e dëshmive të përdorura;
- shkeljet e njëjta esenciale të pohuara të procedurës penale janë të pranishme në aktvendimin e lëshuar nga Gjykata Supreme në shkallën e dytë që refuzoi ankesën;

b) shkelje të ligjit penal:

- kërkesa sqaron se i pandehuri i ka mohuar akuzat dhe mbrojtja e tij është mbështetur nga palët e dëmtuara në shqyrtimin gjyqësor, prandaj asnjë dëshmi nuk është sjellë për të vërtetuar fajësinë e tij.

Avokati mbrojtës prandaj propozon të anulohen aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë dhe të kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim për pjesën që i përket Sabri ISLAMI-t.

4. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e propozuar në dobi të Sabri ISLAMI-t është e pabazuar.

Shkeljet e pohuara të procedurës penale janë të pabaza.

- Deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në Polici konsiderohen si dëshmi të pranueshme në Gjykatë sipas nenit 156.2 të KPPPK-së “vetëm kur të pandehurit apo avokatit mbrojtës ju është dhënë mundësia që të kundërshtojë atë duke marrë në pyetje atë dëshmitar dikur gjatë fazës së procedurës”.

Kjo do të thotë se deklaratat e dëshmitarëve në Polici konsiderohen sipas Kodit si dëshmi e jo vetëm si informatë për veprimet e mëtutjeshme të policisë.

Në këtë rast dëshmitarët dhe palët e dëmtuara Xhulia DEDA dhe Xhoana LALA kanë dhënë deklaratat e tyre në Polici.


E para është shqyrtuar nga Policia por edhe nga Prokurori Publik i Qarkut më 4 shtator 2004, ku të pranishëm ishin edhe avokatët mbrojtës të tre të pandehurve të cilët kanë marrë në pyetje të tërthortë dëshmitarët.

Xhulia DEDA është marrë në pyetje dhe tërthorazi në pyetje po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Pasi është marrë në pyetje nga Policia, Xhoana LALA është marrë në pyetje nga Prokurori Publik i Qarkut më 31 korrik 2004 në prani të avokatëve mbrojtës të tre të pandehurve. Ajo është marrë në pyetje dhe tërthorazi në pyetje po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Kjo i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 156.2 për pranueshmërinë e deklaratave të këtyre dy dëshmitarëve në polici.

- Pikat e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të lidhura me shkeljet esenciale të procedurës penale me aktgjykimin e shkallës së parë mund të shqyrtohen këtu kur kemi parasysh se pretenduesi konfirmon se shkeljet e njëjta janë përsëritur nga Gjykata Supreme e Kosovës me refuzimin e ankesave.



Sidoqoftë këto pika janë të pabazuara sepse aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka shkuar përmes aktgjykimit të atakuar dhe në njëërën anë ka ekzaminuar qartësinë e diapozitivit dhe përputhshmërinë e tij me arsyetimin (faqet 18-19) dhe në anën tjetër ekzistimin dhe besueshmërinë e gjetjeve faktike apo provave të përdorura për të vërtetuar faktet e akuzës (faqet 19 - 44).

Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj ekzaminon jo vetëm deklaratat e të dyshuarve dhe dëshmitarëve mirëpo gjithashtu edhe provat tjera materiale (si ekzaminimet mjekësore ose shkencore) që konsiderohen si përshkrues të gjendjes faktike, por gjithashtu shqyrton çështjen e besueshmërisë së kësaj prove dhe të dëshmitarëve (faqe 24), sa i përket mungesës së konsiderueshme to mospërputhshmërisë në dëshminë e Xhulia DEDA (faqe 26), sa i përket identifikimit të tre të pandehurve të bërë nga e njëjta dëshmitare (faqe 42), sa i përket posedimit nga ana e Vladimir UKAJ të një kopje të urdhrit gjyqësor duke ia dhënë Xhulia DEDA statusin e dëshmitarit anonim, sa i përket faktit që vulat hyrëse nuk ishin vendosur me radhë në pasaportë me rastin e hyrjes nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas (faqet 41 dhe 42), sa i përket besueshmërisë së deklaratave të ndryshme të Xhoana LALA (faqet 28 - 38), sa i përket besueshmërisë së dëshmimeve të tjera, sa i përket vlerësimit të deklaratave të të pandehurve (faqet 38 – 44).

Në arsyetimin e të dy aktgjyqimeve të Gjykatës Supreme dhe të Gjyqtarit të shkallës së parë (faqet 7 - 13) ka një vlerësim të kompletuar të provave të mbledhura dhe vlerës së tyre sa i përket rikonstruksionit të gjendjes.

Rezultatet përfundimtare duket të jenë korrekte dhe nuk ka shkelje të dispozitave ligjore të gjykuara nga mbrojtja.

5. Shkeljet e pretenduara të ligjit penal, siç është propozuar nga avokati mbrojtës në kërkesën e tij, është në fakt pretendim për ekzistimin e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike në aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë.


Në të vërtetë ekzistimi i provave, rëndësia dhe interpretimi korrekt i deklaratave të palëve të dëmtuara, vlerësimi i alibisë së të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij mbi meritat e shkakut janë të gjitha elemente të gjendjes faktike, ekzaminimi i të cilës është i ndaluar përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë sipas nenit 451.2 të KPPPK-së.

III

6. Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Dytë vërtetohet në tërësi.

Vërtetimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Dytë ka efekt në shpenzimet e procedurave të kësaj Shkalle të cilat do të bartin njësoj të dy të pandehurit Vladimir UKAJ dhe Sabri ISLAMI.

Për këto arsye është vendosur si në dispozitiv.



Sot më 1 qershor 2009.

Pkl.-Kzz Nr. 106/2007

Pn-Kr 165/2009



Pregatitur në gjuhën angleze si gjuhë e autorizuar.

Kryetari i Kolegjit Ndërkombëtar
Emilio Gatti

Procesmbajtësja Ndërkombëtare
Annette Andersen

Gjyqtari Ndërkombëtar
Norbert Koster

Gjyqtari Vendor Kosovar
Agim KRASNIQI

Gjyqtari Vendor Kosovar
Avdi DINAJ

Gjyqtari Vendor Kosovar
Miftar Jasiqi

Mjeti Juridik

Kundër një pjese të këtij Aktgjykimi duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur në emër të Sabri ISLAMIT nuk është e mundur të paraqitet kërkesë tjetër për mbrojtjen e ligjshmërisë (neni 451.2 KPPPK-së).

Kundër një pjese të këtij Aktgjykimi duke vendosur mbi papranueshmërinë e ankesës së Vladimir UKAJ dhe Sabri ISLAMIT është e mundur paraqitja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitet në gjykatën e cila ka lëshuar vendimin në shkallën e parë, brenda tre muajve të dorëzimit të këtij vendimi (neni 451 – 460 KPPK-së).